**RAPORTI I AUDITUESIT LIGJOR**
PËR AUDITIMIN E FONDEVE DHE SHPENZIMEVE TË FUSHATËS ZGJEDHORE NGA SUBJEKTET ZGJEDHORE PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE 2019 **TË SUBJEKTIT ELEKTORAL "PARTIA E GJELBËR"**



# I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

## A. INFORMACIONI LIGJOR

### i. Kuadri ligjor

Ligji nr. 10091, date 5.03.2009 "Per auditimin ligjor, Organizimin e Profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe Kontabilistit te Miratuar" i ndryshuar
Standartet Nderkombetare te Auditimit
Ligji nr. 10019 date 29.12.2008, Kodi Zgjedhor i R. Sh. i ndryshuar.
Ligjin nr. 8580, date 17.02.2000, "Per partite politike" i ndryshuar me ligjin nr.90/2017 date 22.05.2017,
Aktet nenligjore te KQZ
Vendim Nr. 740, datë 31.05.2019 "Për shpalljen e rezultatit te shortit per emerimin e eksperteve financiare dhe audituesve ligjore të cilet do te kryejne monitorimin dhe auditimin e fondeve dhe shpenzimeve te fushates zgjedhore nga subjektet zgjedhore per organet e qeverisjes vendore te vitit 2019.

### ii. Standardet e kontabilitetit të zbatueshme

Standartet Kombetare te Kontabilitetit SKK

## B. OBJEKTI I AUDITIMIT

### i. Kontrata e shërbimit

Kontrata e shërbimit nr. 5065 prot. Date 01.06.2019, me objekt "Kryerja e auditimit ligjor te detyrueshem te fondeve te perfituara dhe te shpenzuara gjate fushates zgjedhore per zgjedhjet per Organet e Qeverisjes Vendore te dates 30.06.2019, per partite politike ne perputhje me Kodin Zgjedhor, ligjin nr. 8580, date 17.02.2000, "Per Partite Politike", I ndryshuar, ligjin nr. 10091 date 05.03.2009 "Per Auditimin Ligjor, Organizimin e Profesionit te Ekspertit Kontabel te Regjistruar dhe Kontabilistit te Miratuar" dhe Ligjin nr. 9228, dt, 29.04.2004 " Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", si dhe aktet nenligjore te nxjerra ne baze dhe per zbatim te tyre.

### ii. Vendimi i KQZ-së

Vendimi i KQZ-së nr. 740, date 31.05.2019 -:Per shpalljen e rezultatit te shortit per emerimin e eksperteve financiare dhe audituesve ligjore, te cilet do te kryejne monitorimin dhe auditimin e fondeve dhe

shpenzimeve te fushates zgjedhore nga subjektet zgjedhore per organet e qeverisjes vendore te vitit 2019.

**iii. Përgjegjësitë përkatëse të subjektit zgjedhor dhe audituesit ligjor**

*Përgjegjësitë e subjektit zgjedhor*

Subjekti zgjedhor është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të te dhenave sipas formatit te standardizuar te raportimit financiar per fushaten zgjedhore , dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e raportit financiar që nuk përmban anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të subjektit zgjedhor.

*Përgjegjësitë e Audituesit*

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat e raportimit financiar per fushaten zgjedhore në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

-Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat e raportimit financiar per fushaten zgjedhore, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë proçedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë sesa rreziku që rrjedh nga gabimi, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, ose anashkalime të kontrolleve të brendshme.

Rruga Artan Lenja, Kompleksi Magnet, Tiranë
Email: merilika@outlook.com
Tel: 069 20 24 448

-Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për proçesin e auditimit me qëllim hartimin e proçedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e funksionimit të kontrollit të brendshëm.

-Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera

-Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave te raportimit financiar per fushaten zgjedhore dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

## C. PREZANTIMI I SUBJEKTIT ZGJEDHOR

### i. Prezantimi i subjektit zgjedhor

Subjekti zgjedhor Partisa e Gjelbër" e ka fituar zotësine juridike për të vepruar, në bazë të Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me Nr.3775 datë 08/11/2001. Adresa zyrtare e selisë së Partisë është Rruga Ded Gjon Luli, Pal.3,SHk.1,Ap.31 Tiranë.
Aktet e themelimit dhe të ndryshimeve të drejtimit të kësaj Partie janë të depozituara në regjistrin e partive politike. Drejtimi i sotëm i Partisë bëhet nga kryetari z. Edlir Petanaj, përgjegjës për komunikimin Luis Jazxhi dhe financier Andi Hoxha. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave te ligjit nr. 8580 dt 17.2.2000 "Per partite politike", i ndryshuar; ligjit 8788 dt. 7.05.2001 " Per Organizatat Jofitimprurese", ligjit 8779, dt 7.05.2001 "Per regjistrimin e organizatave jofitimprurese", nga statuti i saj dhe ligjet e tjera ne fuqi.
Qellimi dhe objektivat e Partisë së Gjelbër gjejne pasqyrim ne Programin dhe Statutin e saj. (Link) Ne kete statut ajo ka rregulluar menyren e organizimit dhe funksionimit te saj, ka percaktuar organet drejtuese në nivel qëndror dhe lokal. Aty janë përcaktuar dhe te drejtat e detyrimet e anetaresise se saj, burimet e financimit, te cilat duhet te jene ligjore si dhe rregullat e përdorimit te ketyre fondeve ne dobi te aktivitetit politik te kesaj partie

### ii. Forma e organizimit dhe menaxhimit (qendra dhe degët rajonale)

Seksioni është njësia themelore organizative e Partisë së Gjelbër. Formohet nga jo me pak se tre antarë partie. Ngrihet sipas vëndbanimit në bazë rajoni apo lagje qyteti, fshati ose grupi banesash. Mblidhet jo me rrallë se një herë në tre muaj me kërkesën e kryetarit të saj ose të degës zonale, të Kryesisë së P.GJ të Degës së qarkut si dhe me kërkesën e një të tretës të antarëve të saj. Në mbledhjen dhe veprimtarit e seksionit të Partisë mund të ftohen të marrin pjesë edhe përkrahës ose mbështetës të P.GJ.

Për drejtimin e punëve të përditeshme, seksioni zgjedh Kryetarin dhe një Sekretar. Mbledhjen për analizën e veprimtarisë së përgjithshme dhe zgjedhjet e zhvillon, si rregull një here në tre vjet, në prag të konferencës së Partisë së Degës së qarkut.

Seksioni ka këto detyra kryesore :
- Të marre pjesë në përpunimin e zbërthimin dhe zbatimin e politikës së P.GJ-së, të programit të saj dhe të statutit.
- Të përpunoj, zbërthej dhe zbatoje politikën e P.GJ-së, bazuar në programin, statutin dhe vendimet e organeve drejtuese, në kushtet konkretet të teritorit ku ajo vepron.
- Të mbaj dhe të zhvilloj lidhje me përkrahsin e P.GJ-së.
- Të zgjeroj ndikimin e P.GJ-së, në shtresat e ndryshme të shoqërisë.
- Të mbaje lidhjet me organizmat publike, shoqatat e forca të tjera politike në teritorin ku ajo vepron, në përputhje me programin dhe objektivat e P.GJ.
- Të mbajë qëndrim ndaj cilitdo antari të saj që shkel ligjet e Republikës së Shqipërisë, si dhe normat që shprehen në këtë Statut dhe në Programin e Partisë

## D. PARAQITJA E RAPORTIT DHE STRUKTURA E TIJ

i. Struktura e raportit të auditimit
   – kërkesat formale
   - të ardhurat
   - shpenzimet
ii. Gjate procesit te auditimit, audituesi ligjor ka kontaktuar me z, Edlir Petanaj kryetar i partisë, me Blerina Veli (Sekretare e Përgjithshme), Keida Ushtelenca (Kordinatore e fushatës) dhe Andi Hoxha (Financier),  .
iii. Partia e Gjelbër **e ka** pergatitur raportin e financimit të fushatës zgjedhore.

# II. KËRKESAT FORMALE

## *A.* PËRMBLEDHJE

| 1/ Data e dorëzimit | | | |
|---|---|---|---|
| | a) dorëzim në formë elektronike | Po | 14/10/2019 |
| | b) dorëzim fizik | Po | 14/10/2019 |
| **2/ Nënshkrimi** | | | |
| | Nënshkrimi | Po | 24/09/2019 |
| **3/ Llogaria bankare e veçantë / Personi përgjegjës  i financës** | | | |
| | a) evidenca e hapjes së llogarisë bankare | Po | 28/05/2019 **(Link 2)** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | b) Dokumenti i lëvizjeve në llogarinë bankare (bank statement) që mbulon periudhën e fushatës | Po | |
| | c) identiteti i personit përgjegjës të financës | Po | Andi Hoxha |

### *B.* ANALIZA

**a/ Llogaria bankare e veçantë**

- **Llogaria bankare**
    - Është hapur llogaria bankare e subjektit zgjedhor për fushatën zgjedhore dhe për të marrë donacionet që kalojnë shumën 100,000 Lekë, pamvaresisht se nuk ka pasë donacione mbi këtë vlerë. **(Link 2)**
    - Nuk ka ndonjë llogari bankare tjetër, që është përdorur për të marrë financime publike dhe për të paguar shpenzimet.
- **Plotësia e informacionit**
    - Kam evidencë të plotë në lidhje me llogaritë bankare, nëpërmjet statement të veprimeve bankare, të dy llogarive, si e llogarisë së fushatës dhe e llogarisë së përhershme të subjektit.
    - Kam të dokumentuar cdo të ardhur dhe cdo shpenzime të kryer nga subjekti.

**b/ Personi përgjegjës për Financën**

- **Identiteti i personit përgjegjës për financën:**
    - Personi përgjegjës për thesarin (financat) e partise në dokumenta është z. Andi Hoxha.
    - Çështje të mospërputhjeve të mundshme – Nuk ka.

- **Përgjegjësi për përgatitjen dhe nënshkrimin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore:**
    - Përgjegjës për përgatitjen e raportit ka financieri Andi Hoxha dhe kryetari Edlir Petanaj pasi këta janë dhe dy personat që kanë firmosur raportin financiar.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | a) bosh/mungon informacioni | po | | |
| | b) dokumentacioni (shqyrtim i shpejtë) | | | |
| | | ***Të Ardhurat*** | | |
| | | | Financime publike | 1,260,572.00 |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | (Link1, Link 2) | Donacione private | 0 |
| | | | Financim nga burimet e veta të partisë | 0 |
| | | | Huatë/Kreditë | 0 |
| | | | | |
| | | ***Shpenzimet*** | | |
| | | | Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës | 12,700.00 |
| | | | Materialet promovuese | 821,400.00 |
| | | | Media | 0 |
| | | | Sondazhe të Opinionit Publik | 0 |
| | | | Botime | 0 |
| | | | Transporti | 114,500.00 |
| | | | Konsulenca | 0 |
| | | | Reklamime në ambiente të hapura | 0 |
| | | | Administrative dhe të përgjithshme | 188,610.00 |

## III. <u>TË ARDHURAT</u>

### *A.* PËRMBLEDHJE

| | | **Sipas raportit të financimit të fushatës zgjedhore** | **Sipas auditimit të kryer** |
|---|---|---|---|
| **1/ Financimi publik** | | | |
| | Shuma e pagesës paradhënie | 1,037,258.00 | 1,037,258.00 |
| | Data e tranfertës | 26/06/2019 | 26/06/2019 |
| | Shuma e pagesës së marrë pas zgjedhjeve | 223,314.00 | 223,314.00 |
| | Data e transfertës | - | - |
| | Shuma e financimit publik e kthyer, nëse ka | 0 | 0 |
| | Data e transfertës | - | - |
| **2/ Donacionet private** | | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Shuma e përgjithshme e raportuar | 0 | 0 |
| | Shuma e donacioneve në para | 0 | 0 |
| | Shuma e donacioneve në natyrë | 0 | 0 |
| | Përgatitet një listë e donatorëve | | ska |
| | Përfshihen të gjitha dokumentet e lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) | | ska |
| | Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (shuma) | | N/A (nuk ka) |
| | Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (data) | | N/A (nuk ka) |
| | Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (donatori) | | N/A (nuk ka) |
| | Përputhshmëria mes çdo donacioni në natyrë të raportuar dhe vlerës së tregut (donatori / data) | | N/A (nuk ka) |
| | A përputhen shifrat në total (të përgjithshme)? | | N/A (nuk ka) |
| | Respektimi i kufirit të donacionit | | N/A (nuk ka) |
| **3/ Financimi nga burimet e vetë partisë** | | | |
| | Shuma e përgjithshme e raportuar | 0 | 0 |
| | Shuma e përgjithshme e raportuar (Zyra Qendrore) | - | - |
| | *Kuotat e anëtarësisë* | - | - |
| | *Botimet* | - | - |
| | *Shtypshkronja* | - | - |
| | *Marrje me qera* | - | - |
| | Shuma e përgjithshme e raportuar (degët lokale) | - | - |
| | *Kuotat e anëtarësisë* | - | - |
| | *Botimet* | - | - |
| | *Shtypshkronja* | - | - |
| | *Marrje me qera* | - | - |
| | Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement)(shuma) | - | - |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Përputhshmëria mes çdo të ardhure të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare (bank statement) (data) | | - |
| **4/ Huatë/Kreditë** | | | |
| | Shuma e përgjithshme e raportuar | 0 | 0 |
| | Shuma / shuma e huasë / kredisë (për çdo kredi / hua) | 0 | 0 |
| | Data e huasë / kredisë dhe data e shlyerjes (për çdo kredi / hua) | - | - |
| | Paraqitja e dokumenteve mbështetëse (kontratat për secilën kredi / hua) | - | - |
| **5/ Marrja/Arkëtimi i të ardhurave** | | | |
| Të gjithë të ardhurat në para të marra / të mbledhura përmes llogarisë specifike. | | 1,037,258.00 | 1,037,258.00 |

## *B.* ANALIZA

**a/ Financimi publik**

- Partia e Gjelbër deklaron se në bazë të vendimit 830 datë 10/06/2019 http://cec.org.al/ëp-content/uploads/2019/06/venimi-830.pdf; http://cec.org.al/ëp-content/uploads/2019/06/Lidhja-Nr-1.pdf ka marrë në llogarinë e tij nr 0030047195 në bankën Raffeisen shumën prej 1,037,258.00 lekë.
  Dhe me vendimin Nr 10098 datë 27/07/2019
  http://cec.org.al/ëp-content/uploads/2019/10/Vendim-10098-Per-shperndarjen-e-fondeve-te-fushates-2019.pdf
  http://cec.org.al/ëp-content/uploads/2019/10/Lidhja-1.pdf
  është aprovuar dhe shtesa e fondit prej 223,314.00 lekë.

**b/ Financimi nga burimet jo publike**

- **Donatorët e lejuar:**
  - Kontrolli i identitetit të donatorëve dhe lejueshmëria e çdo donacioni të deklaruar:
    Subjekti nuk ka pasur financime jo publike në fushatën zgjedhore të 30 qershor 2019.
- **Burimet e palejuara – nuk ka**
- **Kontributet në natyrë – nuk ka**

  - **Kufizimet**
    Ka shpenzime për fushatën zgjedhore, por nuk ka shkelje të kufizimeve.

Rruga Artan Lenja, Kompleksi Magnet, Tiranë
Email: merilika@outlook.com
Tel: 069 20 24 448

**c/ Financimi nga burimet e vetë partisë politike**

- **Klasifikimi sipas zërave i të ardhurave nga burimet e vetë partisë**
  - Kuotat e anëtarësisë: shuma e përgjithshme dhe e detajuar sipas shumave të marra – nuk ka
  - Botimet – nuk ka
  - Shtypshkronjat – nuk ka
  - Marrja me qera, etj – nuk ka
- **Klasifikimi i të ardhurave që merren nga burimet e vetë partisë për secilin zë të deklaruar sipas emrit të degës**
  - Zyrat Qendrore - 0
  - Degët lokale - 0
- **Përputhshmëria mes natyrës dhe shumës së të ardhurave të deklaruara dhe deklarimit bankar (bank statement)**

  N/A , jo e aplikueshme

**d/ Huatë/Kreditë – nuk ka**

## *IV.* SHPENZIME

### *A.* PËRMBLEDHJE

| | | |
|---|---|---|
| Shuma e përgjithshme e raportuar | 1,237,310.00 lekë | |
| Respektimi i kufirit të shpenzimit | Është respektuar kufiri | |
| **Shpenzimet e kryera nga Zyra Qendrore e partisë** | | |

| | **Shpenzimet zgjedhore të deklaruara në raportin e financimit të fushatës zgjedhore** | Faturat e paraqitura | Faturat e Përgjithshme | Dokumente mbështetëse që mungojnë | Shpenzime të papaguara | Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët | **Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Aktivitetet të fushatës | 12,700.00 | Po | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka | 12,700.00 |
| Materialet | 821,400.00 | Po | Nuk ka | Nuk ka | 150,000.00 | Nuk ka | 821,400.00 |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| promovuese | | | | | | | |
| Media | 0 | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka | 0 |
| Sondazhet e opinionit publik | 0 | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka | 0 |
| Botimet | 0 | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka | 0 |
| Transporti | 114,500.00 | Po | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka | 114,500.00 |
| Konsulenca | 0 | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka | 0 |
| Reklamat në ambientet e jashtme | 0 | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka | 0 |
| Administrative dhe të përgjithshme | 188,610.00 | Po | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka | Nuk ka | 188,610.00 |

**Shpenzimet e bëra nga degët e partisë**

| | **Shpenzimet zgjedhore të deklaruara në raportin e financimit te fushatës zgjedhore** | Faturat e paraqitura | Faturat e Përgjithshme | Dokumentet mbështetëse që mungojnë | Shpenzime të papaguara | Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët | **Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës | - | | | | | | - |
| Materialet promovuese | - | | | | | | - |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Media | - | | | | | | - |
| Sondazhet e opinionit publik | - | | | | | | - |
| Botimet | - | | | | | | - |
| Transporti | - | | | | | | - |
| Konsulenca | - | | | | | | - |
| Reklamat në ambientet e jashtme | - | | | | | | - |
| Administrative dhe të përgjithshme | - | | | | | | - |
| **Shpenzimet zgjedhore** | | | | | | | |
| Shpenzime zgjedhore nuk ka | | | | | | | Nuk ka |

### *B.* ANALIZA

**a/ Respektimi i kufirit të shpenzimeve:** - Është respektuar kufiri i përcaktuar nga Kodi Zgjedhor, i cili parashikon që shpenzimet e përgjithshme të bëra nga një parti politike, duke përfshirë kandidatët e saj, për një fushatë zgjedhore nuk duhet të kalojnë 10 herë shumën më të lartë që një subjekt zgjedhor ka marrë nga fondet publike

**b/ Analiza e të gjithë shpenzimeve të deklaruara dhe klasifikuara sipas degës së partisë dhe kategorisë, në përputhje me modelin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore.**

- Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës : Dega Qendrore 12,700.00 lekë **(Link)**
- Materialet promovuese: Dega Qendrore 821,400.00 lekë
- Media , nuk ka
- Sondazhet e opinionit publik, nuk ka
- Botimet, nuk ka
- Transporti: Dega Qendrore 114,500.00 lekë
- Konsulenca, nuk ka
- Reklamat në ambientet e jashtme, nuk ka
- Administrative dhe të përgjithshme: Dega Qendrore 188,610.00 lekë

## V. PËRFUNDIMI

### *A.* SINTEZA

- Përmbledhja e gjetjeve dhe përfundimeve

Partia e Gjelbër ka deklaruar saktë të ardhurat dhe shpenzimet e fushates zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019. Të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara janë të mbështetura në dokumente justifikuese. Shpenzimet e saj nuk e kalojnë kufirin e përcaktuar nga Kodi Zgjedhor.

- Lista e parregullsive të gjetura gjatë proçesit të auditimit –

Gjatë auditimit nuk kemi gjetur paregullsi në lidhje me raportimin financiar të fushatës zgjedhore për organet e qeverisjes vendore të vitit 2019 nga ana e subjektit Partia e Gjelbër nuk ka hapur llogari bankare për fushatën.

- Krahasimi me raportin e monitorimit të ekspertit financiar

  Ne raportin e monitorimit te ekspertit financiar nuk jane konstatuar shkelje te rregulloreve apo ligjeve. Të dhënat e raportuara nga subjekti Partia e Gjelbër, përputhen me raportin tonë.

### *B.* PËRFUNDIMI

**Opinioni pa rezervë**

Ne kemi audituar raportimin financiare të subjektit zgjedhor "Partia e Gjelbër", të cilat përfshijnë lëvirimin, përdorimin dhe zbatimin e ligjshmërisë së fondeve të fushatës për zgjedhjet vendore qershor 2019.
Sipas opinionit tonë, raportimi financiare i deklaruar nga subjekti "Parti e Gjelbër" është i saktë dhe në përputhje me Kodin Zgjedhor.

Subjekti

- Zbaton ligjin fiskal për identifikimin e tij pranë organeve tatimore.
- Hap llogari të veçantë bankare për fushtën zgjedhore e ndryshme nga llogaria gjithvjetore.
- Nuk kalon kufirin e lejuar të shpenzimeve sipas Kodit Zgjedhor.
- Bën në kohë raportimin financiar.
- Nuk nxjerr asnjë pengesë në aksesin ndaj informacionit dhe dokumentacionit.
- Ka të mbështetur në dokumente justifikuese cdo shpenzim që ka kryer.

**Baza për Opinionin**

Ne kryem proçedurat për auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më

Rruga Artan Lenja, Kompleksi Magnet, Tiranë
Email: merilika@outlook.com
Tel: 069 20 24 448

të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit. Ne jemi të pavarur nga subjekti zgjedhor në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave, raporteve financiare në Shqipëri, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme për të dhënë një bazë për dhënie të opinionin tonë dhe theksimit të çështjeve në dhënien e opinionit.

Auditues Ligjor

**Meri Lika**

*16 dhjetor 2019*

MERI LIKA
NUIS : L 41528005 F
Tiranë - Albania